



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:123206

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05628084

KPPP.nr. 2046/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, me numër të biznesit 70064420 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.D., avokat nga Prishtina, kundër debitorit SHBI “Ylberi” me numër regjistrimi të biznesit 70176471 me seli në Mitrovicë, i përfaqësuar nga Y.D. me numër personal ..., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Aktvendimit E.Nr.766/14, i lejuar me datë 05.06.2014, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës më 23.04.2024, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit SHBI “Ylberi”, dhe Aktvendimit E.Nr.766/14, i lejuar me datë 05.06.2014, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C., mbi bazën e dokumenteve të besueshme, faturave të nxjerra konform Kontratës së Parapagimit për biznese e datës 01.12.2009, Kontrata e Abonimit për biznes pako 01.12.2009, Aneksi për Biznese me Parapagimin 01.12.2009, Aneksi i Kontratës për Shërbime të Telefonisë Mobile të datës 01.12.2009, përmes të cilave është ofruar shërbim i telefonisë mobile, ashtu që ka obliguar debitorin SHBI “Ylberi”, që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4944.02€ me kamatë prej 3.5%

në vit, duke filluar nga data 01.15.2010 si datë e dërgimit të faturave për pagesë e deri në pagesën definitive.

Debitori, ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, pasi që është arritur afati i parashkrimit. Po ashtu, ka theksuar se për obligimin që kishte ndaj kreditorit, debitori ka marr obligime që përmes “Radio Ylberi” të bëj reklamimin në emër dhe llogari të kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar. Gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se kundërshton në tërësi deklarimin e kreditorit e posaçërisht deklarimin lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit.

Kreditori mbetet në tërësi pranë propozimit për përmbarim duke i propozuar gjykatës që aktvendimin Gjykatës Themelore në Prishtinë, ta lë në fuqi për borxhin në shumën prej 2,215.65€ dhe të detyrohet debitori që kreditorit të ja paguaj këtë borxh për periudhën kohore nga data 31.05.2011 deri më datë 29.02.2012 me kamatë ligjore si në propozim. Tutje ka theksuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë respektivisht marrëveshje që pretendon se ndërmjet kreditorit dhe debitorit ka ekzistuar një marrëveshje sipas të cilës siç pretendon debitori, kreditori ka qenë i obliguar që ti ofroj shërbime të telefonisë mobile ndërkaq debitori ti bëjë reklama përmes radios. Më tej në lidhje me këtë marrëveshje ka deklaruar se e njëjta nuk është e vlefshme sepse nuk i përmban elementet e domosdoshme që duhet ti ketë secila marrëveshje dhe se kreditori nuk është nënshkruar i sa. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë si dhe pas shqyrtimit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se Aktvendimi për lejimin e përmbarimit duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton

faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se të njëjtat në shkresa të lëndës janë paraqitur në kopje ndërsa nuk janë paraqitur në origjinal apo kopje të vërtetuar sipas ligjit.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit E.Nr.766/14, të datës 05.06.2014, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit, nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar si dokument i besueshëm, andaj gjykata vendosi që të pranoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhërin përmbarimor si në dispozitiv.

Meqenëse dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, gjykata nuk vlerësoi fare pretendimet e debitorit mbi përfshirjen e disa faturave në parashkrim.

Po ashtu, gjykata nuk vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me marrëveshjen për kompensimin e shërbimeve të telefonisë me shërbimet e reklamimit të cilat debitori pretendon si ia ka ofruar kreditorit, për shkak se kjo çështje nuk ka qenë objekt i procedurës së përmbarimit prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2046/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.